

**AKT THEMELIMI
DHE STATUTI I SHOQËRISË
“Yume”**

Sot, më 12/12/2024, ne Tirane, Shqipëri, unë i nënshkruari Firdeus KASAJ, lindur më 12-10-2005, ne Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjostimit me numër personal: K51012061M në cilësinë e ortakut te vetëm themeloi një shoqëri si më poshtë vijon dhe miratoj statutin e kësaj shoqërie.

**KREU I
EMËRTIMI – SELIA – OBJEKTI - KOHËZGJATJA**

Neni 1

Emërtimi

- 1.1 Shoqëria emërhohet “Yume” (në vijim referuar si “Shoqëria”).
- 1.2 Emërtimi i Shoqërisë ndiqet nga akronimi “Shpk”, sipas kërkave të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar (në vijim referuar si “Ligji Tregtar”) në përputhje me formën e saj juridike, sipas nenit vijues.
- 1.3 Shoqëria ka logon dhe vulën përkatëse, të cilat vendosën në çdo dokument të saj.

Neni 2


Forma Juridike

- 2.1 Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe organizuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar.
- 2.2 Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me këtë Statut.

Neni 3

Selia

- 3.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën:
“Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga "Fuat Toptani", Vila Nr.1, Kati 3, Tiranë, Shqipëri”.
- 3.2 Administratori/ët mund të hapë/in dhe/ose mbyllë/in degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat do të ushtrojnë veprimtarinë sipas kompetencave dhe kufizimeve të vendosura nga Ortaku i Vetëm dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj për një asfat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit te saj në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- 4.2. Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohen me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi.
- 4.3. Shoqëria mund të prishet gjithashtu për shkaqe ligjore, të pavarura nga vullneti i Ortakut të Vetëm.

Neni 5

Objekti i Veprimitarisë

- 5.1. Yume ka per objekt zhvillimin, menaxhimin, administrimin dhe operimin e një platforme teknologjike te avancuar dhe multifunksionale, e cila eshte e aksesueshme nepermjet aplikacioneve mobile, web dhe pajisjeve te tjera dixhitale. Kjo platforme synon te ofroje një game te gjere sherbimesh dhe funksionalitetesh, duke perfshire lehtesimin e procesit te kerkimit dhe aplikimit per pune nga individet, krijimin e një sistemi te personalizuar ku perdoruesit mund te ndertojne profile profesionale me te dhena mbi astesite, pervojet dhe preferencat e tyre, dhe te gjejne mundesi pune te pershtatura per ta. Platforma ofron hapesira te dedikuara per organizatorët e eveneteve, duke mundesuar promovimin, menaxhimin dhe monitorimin e aktivitetit te tyre permes mjeteve teknologjike te avancuara qe perfshijnë regjistritë te automatizuara, skanimin e biletave me QR kode dhe menaxhimin e pjesemarrësve ne kohe reale. Yume gjithashtu krijon një hapesirë profesionale per ndarjen e njohurive, pervojaqe dhe krijimin e lidhjeve te reja mes profesionisteve nga fusha te ndryshme, duke mundesuar një komunitet te hapur per bashkepunim dhe zhvillim profesional.

Nepermjet perdorimit te inteligences artificiale, Yume siguron personalizimin e pote te eksperencies se perdoruesve, duke analizuar sjelljet, preferencat dhe te dhurat per te ofruar sugjerime te personalizuara si pune, evenete apo kontakte profesionale. Platforma mbeshtet gjithashtu integrimin e sherbimeve te pagesave, duke mundesuar transaksione te sigurta dhe te lehta per pjesemarrjen ne evenete, promovimin e aktiviteteve apo perfitimin e sherbimeve premium. Pagesat dhe transaktionet financiare kryhen ne përputhje me standartet nderkombetare te sigurise, duke ofruar transparence dhe gjurmueshmeri per çdo operacion ekonomik te realizuar ne platforme.

Nje nga funksionalitetet kryesore te Yume eshte menaxhimi i shitjeve dhe blerjeve te sherbimeve te ofruara nga perdoruesit, partneret dhe platforma vete, duke krijuar një ekosistem te qendrueshem per operacione tregtare te brendshme dhe te jashtme. Platforma lejon perdoruesit te ofrojne sherbime per te tjeret, te krijojnë produkte dixhitale, te organizojnë aktivitete dhe te kryejnë shitje te sherbimeve apo produkteve permes një sistemi te integruar. Per partneret komerciale dhe bizneset, Yume ofron mundesi bashkepunimi per zhvillimin dhe promovimin e perbashket te projekteve, integrimin e sherbimeve te tyre ne platforme dhe krijimin e modeleve te personalizuara te bashkepunimit.

Firdaus Kasqjif

Yume operon me një infrastrukturë te sigurt dhe te standardizuar për menaxhimin e te dhenave, duke perfshire perdorimin e IP-ve publike për transparency dhe qasje te sigurt ne te dhenat e perdoruesve. Te dhenat ruhen dhe menaxhohen sipas standardeve nderkombetare për mbrojtjen e privatesise dhe sigurise, duke siguruar enkriptimin e te dhenave dhe parandalimin e aksosit te paautorizuar. Platforma perqendrohet gjithashtu ne ndertimin e një infrastrukturë teknologjike te shkallezueshme dhe te qendrueshme, e cila eshte e afte te mbeshtese rritjen e numrit te perdoruesve dhe nevojave te tregut.

Yume synon krijimin e një ekosistemi inovativ që adreson nevojat e perdoruesve individuale dhe bizneseve duke ofruar një sistem te integruar per punesim, promovim, zhvillim profesional dhe tregti dixhitale. Ne te njejten kohe, platforma ofron mundesi per bashkepunime me kompani te tjera, organizata dhe institucionë per te siguruar zhvillimin e qendrueshem te sherbimeve te saj dhe per te permbyshur kërkesat e tregut modern. Kjo qasje holistikë garanton që Yume te jetë një mjet i domosdoshem per suksesin profesional dhe social ne epoken dixhitale, duke krijuar vlerë te shtuar per te gjitha palet e perfshira dhe duke siguruar një zhvillim te qendrueshem dhe te vazhdueshem te aktiviteteve te saj. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por nuk do të kufizohet në:

- 5.2. Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimtaritë e dobishme dhe/ose të nevojshme të lejuara nga legjislacioni në fuqi, për realizimin e objektit të veprimtarisë së Shoqërisë.
- 5.3. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet, përditësohet, plotësohet në çdo moment, me vendim të Ortakut të Vetëm.

KREU II KAPITALI DHE KUOTA

Neni 6

Kapitali

- 6.1. Kapitali i Shoqërisë është 500.000 (*peseqindemije*) lekë.
- 6.2. Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar tërsisht dhe përbehet nga 1 (*nje*) kuotë, në përputhje me nenin 7 vijues.

Neni 7

Ortaku i Vetëm

- 7.1. Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është:

- Firdeus KASAJ, shtetase Shqiptare, lindur më 12.10.2005, ne Tirane, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal: K51012061M, zotëruesh i 1 (*nje*) kuote që i korrespondon 100% të kapitalit themeltar në shumën prej 500.000 (*peseqindemije*) lekë.

Firdeus Kasaj

Neni 8

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

- 8.1. Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet në çdo kohë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 8.2. Shoqëria në çdo kohë mund të zvogëloje kapitalin me vendim të Ortakut të Vetëm. Në çdo rast, kapitali nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e vlerës së kapitalit të kërkuar nga Ligji Tregtar.
- 8.3. Kontributi i mëtejshëm i Ortakut të Vetëm në kapitalin e Shoqërisë mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme, kuota apo të drejta). Mënyra e shlyerjes së kontributeve do të përcaktohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 9

Transferimi i Kuotës

- 9.1. Ortaku i Vetëm mund të vendosë në çdo kohë për pjesëtimin dhe transferimin e kuotës përmes shitjes, dhurimit, apo ndonjë mënyre tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
- 9.2. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, Ortaku i Vetëm përcakton kushtet, momentin e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, momentin e pagesës së çmimit, në kontratën e kalimit të kuotës, e cila hartohet në formë shkresore, sipas dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm.

KREU III ORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 10

Organet e Shoqërisë

- 10.1. Organet e Shoqërisë janë si vijon:

- Ortaku i Vetëm – organi më i lartë vendimmarrës;
- Administratori/ët – organi më i lartë ekzekutiv.

KREU IV VENDIMMARRJA DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 11

Vendimmarrja

- 11.1. Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë është Ortaku i Vetëm.

Fikreus Kaspi /M/

11.2. Ortaku i Vetëm merr vendime për të nbrojtor dhe zhvilluar interesat e Shoqërisë, në çdo moment.

11.3. Ortaku i Vetëm është përgjegjes, ndërsa tjetra, përvendime në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- përaktimin e politikave të biznesit të Shoqërisë;
- ndryshimin, modifikimin, plotësimin e statutit;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve, vendosjen dhe ndarjen e kompetencave të tyre, si dhe shpërblimin përkates;
- përaktimin e procedurave të mbledhjes së administratorëve përmarrjen e vendimeve lidhur me administrimin e Shoqërisë;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatijen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimitarisë;
- emërimin dhe shkarkimin e ekspertit/ëve kontabël dhe likuiduesve dhe shpërblimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera ndaj administratorëve;
- zmadhimin dhe/ose zgogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin dhe transferimin e kuotës;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarisë;
- shpërndarjen e fitimeve;
- Riorganizimin, prishjen dhe/ose likuidimin e Shoqërisë; dhe
- çdo çështje tjeter të parashikuar nga legjislacioni i zbatueshëm dhe ky Statut.

Neni 12

Regjistri i Vendimeve

12.1. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

12.2. Duhet të regjistrohen në vëganti, vendimet e mëposhtme:

- miratimi i pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarisë;
- shpërndaraja e fitimeve dhe humbjeve;
- zmadhimi ose zgogëlimi i kapitalit themeltar;
- veradime në lidhje me investimet;
- riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë.

12.3. Lista e mësipërme nuk është shteruese. Vendime të tjera të Ortakut të Vetëm mund të regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve.

12.4. Vendimet të cilat nuk regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Gjithsesi, Shoqëria nuk mund t'i kundrejojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejtë në

mirëbesim, përvèç rastit kur Shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 13

Administrimi

- 13.1. Shoqëria mund të administrohet nga një apo disa administratorë, numri dhe kompetencat e të cilëve do të përcaktohen me vendim nga Ortaku i Vetëm.
- 13.2. Administratori/ët do të emërohen me vendim të Ortakut të Vetëm dhe mund të shkarkohen në çdo kohë me një vendim të njëjtë.
- 13.3. Administratori/ët zgjidhen në përputhje me kërkësat ligjore dhe kufizimet e Ligjit Tregtar.
- 13.4. Administratorët janë persona fizikë, pa ndonjë kufizim në lidhje me shtetësinë.
- 13.5. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit/ëve do të vendoset në momentin e emërimit, por në çdo rast nuk mund të tejkalojë afatin 5 (pesë) vjeçar.
- 13.6. Kohëzgjatja e mandatit të administratorit mund të ripërtërihet me anë të vendimit të Ortakut të Vetëm, pa kufizim.
- 13.7. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtar Ortakut të Vetëm, i cili duhet të caktojë një administrator të ri apo të ndajë kompetencat ndërmjet administratorëve të mbetur (në rastin kur Shoqëria ka disa administratorë).
- 13.8. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e Shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas legjislacionit të zbatueshëm.
- 13.9. Administratori i Shoqërisë do të jetë Shkëlqim KASAJ, lindur më 25.04.1982, ne Sarande Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal: I20425072F
- 13.10. Mandati i Administratorit të pare të Shoqërisë do të jetë 5 vjet.

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

- 14.1. Administratori është përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe përfaqëson Shoqërinë me palët e treta, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, vendimet e Ortakut të Vetëm dhe legjislacionin e zbatueshëm.
- 14.2. Kompetencat dhe detyrat e administratorit në lidhje me administrimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarinë e Shoqërisë përfshijnë, por nuk do të kufizohen në:
 - a. zbatimin e politikave të biznesit të Shoqërisë dhe vendimet e Ortakut të Vetëm;
 - b. kryerjen e të gjitha veprimeve në lidhje me administrimin e veprimtarisë së biznesit të Shoqërisë;
 - c. sigurimin e mirëmbajtjes së rregullt të dokumenteve financiare dhe kontabël të Shoqërisë;
 - d. sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin dhe standartet e kontabilitetit nga Shoqëria;

Friedaes kosef / M

- e. përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor, bilancit të konsoliduar dhe reportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të cilat paraqiten përpjaka Ortakut të Vetëm për miratim;
 - f. reportimin përpjaka Ortakut të Vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
 - g. përfaqësimin e Shoqërisë me palët e treta;
 - h. njostimin e Ortakun te Vetëm menjëherë për çdo çështje që kërkon vendimmarrjen e tij;
 - i. kryerjen e të gjitha regjistrimeve dhe publikimeve të detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, që kërkojnë sipas legjislacionit në fuqi;
 - j. krijimin e një sistemi paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; dhe
 - k. kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në legjislacionin e zbatueshëm dhe në këtë Statut.
- 14.3.** Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat dhe veprimet, me përashtim të atyre që me ligj dhe nga statuti janë të rezervuara për Ortakun e Vetëm.
- 14.4.** Ortaku i Vetëm përcakton, me vendim përkatës, kufizimet e kompetencave, objektin e kompetencave për administratorin/et dhe, nëse është e nevojshme kur ka me shume se një administrator, procedurat përmblidhjet e administratoreve.
- 14.5.** Në rast emërimi të më shumë se një administratori, Ortaku i Vetëm përcakton me vendim ndarjen e kompetencave ndërmjet tyre, kompetencat të cilat ushtrohen veçmas dhe kompetencat të cilat ushtrohen bashkërisht nga më shumë se një administrator.
- 14.6.** Ndryshimet dhe kufizimet në administrimin e Shoqërisë si më sipër, nuk do të jenë konsiderohen si ndryshim i statutit të Shoqërisë.
- 14.7.** Administratori mund të veprojë vetëm duke marrë parasysh interesin më të lartë të Shoqërisë.
- 14.8.** Administratori mund të delegojë një pjesë ose të gjitha kompetencat e tij tek persona të tjera.

KREU V DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 15

Eksperti Kontabël i Autorizuar

- 15.1.** Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Ortaku i Vetëm, kontrolli i pasqyrave financiare dhe të dhënavë kontabël të Shoqërisë do t'u besohet një ose me shumë ekspertëve kontabël të autorizuar.

Neni 16

Viti Financiar dhe Pasqyrat Financiare

- 16.1.** Viti ushtrimor fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

7

- 16.2. Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe ekspertit kontabel të autorizuar, nëse ka një të tillë, miratohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me Ligjin Tregtar.

Neni 17

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

- 17.1. Ortaku i Vetëm mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me procedurën e likuidimit te saj, sipas dispozitave të Ligjit Tregtar.
- 17.2. Ortaku i Vetëm emëron një ose më shumë likuidues, duke përcaktuar tagrat e tyre në përputhje me legjisacionin në fuqi dhe mund t'i shkarkojë apo zëvendësojë në të njëjtat kushte.
- 17.3. Administratori/ët i Shoqërisë i njofton për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Biznesit, të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre për të përfaqësuar Shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse.
- 17.4. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.
- 17.5. Nëse Shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvëçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.
- 17.6. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të Shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
- 17.7. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se 1 (një) vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Ortaku i Vetëm.
- 17.8. Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik për nevoja të likuidimit deri në përfundim të këtij procesi. Gjate kësaj procedure, togfjalëshi “në likuidim e sipër” duhet të vihet pas emrit të Shoqërisë.

Neni 18

Të dhëna të detyrueshme gjatë kohëzgjatjes së Shoqërisë

- 18.1. Të gjitha shkresat, formularët e urdhreve apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga Shoqëria, degët apo zyrat eventuale të përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:
- numrin unik të identifikimit;
 - formën ligjore të shoqërisë;
 - vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
 - të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;

Tiredas kosej M

- vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit.

18.2. Nëse Shoqëria krijon edhe një faqe interneti, këto të dhëna do të pasqyrohen aty.

Neni 19

Ligji i Zbatueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 19.1. Ky akt bazohet ne legjislacionin shqiptar dhe interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i tij, duhet të kryhen në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 19.2. Për sa nuk parashikohet në këtë akt do të zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi, e në veçanti ato të Ligjit Tregtar.
- 19.3. Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij akti do të zgjidhen nga Gjykata e Juridiksionit te Përgjithshëm, Tiranë.

Ky Statut përpilohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETËM

FIRDEUS KASAJ

Firdeus Kasaj